



**INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIM TË POLITIKAVE**

Seria e botimeve në kuadër të Programit të Edukimit

*Ngritja e kapaciteteve të studentëve dhe të rinjve*

Botimi Nr. 01

# **PERCEPTIMET E OPINIONIT MBI SIGURINË PUBLIKE DHE PUNËN POLICORE NË KOSOVË:**

## **VËSHTRIMI I PERIUDHËS 2000 - 2011**

Prishtinë, qershor 2012

Përgatitur nga: Armend Halimi, *kandidat për M.Sc. në Siguri Nacionale në Universitetin e Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni*

Mbikëqyrur nga: Shpend Kursani dhe Ilir Deda

Copyright © 2012 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Luteni të kontaktoni: [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org) apo +381 38 227 778.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave  
Rexhep Mala, 5A, Kati II  
10 000 Prishtinë, Kosovë  
Telefon dhe Fax: +381 38 227 778  
[www.kipred.org](http://www.kipred.org)

## PËRMBAJTJA

<b>Hyrje .....</b>	<b>5</b>
<b>1. Perceptimi i Opinionit mbi Sigurinë Publike.....</b>	<b>7</b>
1.1. Cili ka qenë viti më i pasigurt në Kosovë?.....	7
1.2. Cilat nga llojet e krimit ndiheni të kërcënuar?.....	7
1.3. Cilat nga vendet (qytet apo fshat) keni frikë t'i vizitoni? .....	9
1.4. A posedoni armë zjarri ju apo ndonjë nga anëtarët e familjes suaj? .....	10
<b>2. Perceptimi i Opinionit mbi Punën Policore.....</b>	<b>13</b>
2.1. Si i vlerësoni organet e rendit dhe të drejtësisë? .....	13
2.2. Çka vlerësoni si përparësi tek Policia e Kosovës? .....	13
2.3. Çka vlerësoni si të metë tek Policia e Kosovës? .....	14
2.4. Si e vlerësoni përgjigjen e policisë ndaj nevojave dhe kërkesave tuaja?.....	15
2.5. Në rast se kërcënoheni apo pësoni nga ndonjë krim, a do të lajmëroni policinë? 15	
2.6. A mendoni se është i mjaftueshëm patrullimi i policisë në lagjet tuaja .....	16
2.7. A jeni keqtrajtuar ndonjë herë nga policia? .....	17
2.8. A keni pasur rast kur policia ka kërkuar ndonjë dhuratë për të kryer apo mos kryer ndonjë shërbim ndaj jush?.....	17
<b>3. Konkluzione .....</b>	<b>18</b>

## **LISTA E FIGURAVE**

### **Perceptimi i opinionit mbi sigurinë publike në Kosovë**

- Figura 1: Vitet më të pasigurta në Kosovë
- Figura 2: Krimet që paraqesin shqetësim në Kosovë
- Figura 3: Numri i vrasjeve në Kosovë sipas vitit
- Figura 4: Numri i krimeve të regjistruara në Kosovë sipas vitit
- Figura 5: Vendet më të rrezikshme sipas opinionit në Kosovë
- Figura 6: Armëmbajtja në Kosovë
- Figura 7: Grupimi i armëmbajtjeve sipas lejes (me apo pa leje) në Kosovë
- Figura 8: Arsyet e mbajtjes së armës në Kosovë (si nevojë apo si traditë?)
- Figura 9: Gatishmëria e qytetarëve për të dorëzuar armët
- Figura 10: Kontrolli për armë nga ana e autoriteteve (policia)

### **Perceptimi i opinionit mbi punën policore në Kosovë**

- Figura11: Renditja e organeve të rendit dhe drejtësisë në Kosovë për nga besueshmëria
- Figura 12: Përparësitë që ka Policia e Kosovës sipas opinionit
- Figura 13: Të metat që ka Policia e Kosovës sipas opinionit
- Figura 14: Vlerësimi i policisë në kryerjen e detyrave
- Figura 15: Raportimi i krimeve në polici ku ka kërcënim direkt
- Figura 16: Raportimi i krimeve në polici ku ka kërcënim indirekt
- Figura 17: Patrullimi i policisë nëpër lagje
- Figura 18: Niveli i keqtrajttimeve të policisë ndaj qytetarëve
- Figura 19: Prania e korrupsionit në polici

## HYRJE

Ky punim është i pari në kuadër të Programit të Edukimit të KIPRED-it i përpiluar në bashkëpunim me studentë dhe të rinj. KIPRED mëton që nëpërmjet punimeve të tilla, e që ndërliken me fushat e hulumtimit të Institutit, të ndihmojë direkt në ngritjen e aftësive të studentëve dhe të rinjve tjerë të dalluar. Nga ky punim hulumtues dalin informata të rëndësishme, e që KIPRED vlerësoi se duhet publikuar në kuadër të këtij Programi. Raporti original është shkruar në gjuhën Shqipe.

Ky raport ka për objekt studimi perceptimin e opinionit për *sigurinë publike* dhe *punën policore* në Kosovë prej vitit 2000 deri në vitin 2011. Metodologjia kryesore e përpilimit të këtij studimi është anketimi me qytetarë nga të cilët është marr perceptimi direkt i tyre sa i përket *kriminalitetit* dhe *punës policore* në Kosovë. Anketimi është bërë me një mostër spontane prej 600 vetave në gjashtë rajone të Kosovës duke përfshi: Gjilanin, Ferizajin, Mitrovicën, Pejën, Prishtinën, dhe Prizrenin. Anketimi është bërë vetëm në qendrat e këtyre rajoneve, nga 100 për secilin rajon. Në qytetin e Mitrovicës anketa është zhvilluar vetëm në pjesën jugore, duke mos përfshi atë të veriut për arsye sigurie. Ndërsa të dhënat primare për këtë studim janë grumbulluar gjatë muajve të parë, përkatësisht muajt shkurt dhe mars, të vitit 2012.

Qytetarët e anketuar janë të moshave të ndryshme dhe përfshinë grup-moshën prej 18 e më lartë, ndërsa sipas gjinisë janë përfshire 343 apo 57.16 % meshkuj dhe 257 apo 42 % femra. Me gjithë faktin që anketat janë zhvilluar vetëm në qendra të qyteteve, 360 apo 60% e të anketuarve vijnë nga qyteti dhe 240 apo 40% nga fshati. Po ashtu qytetarët e anketuar janë kryesisht të komunitetit shqiptarë.<sup>1</sup> Me gjithëatë gjatë anketimit në Mitrovicë është hasur edhe në përgjigjet e dhëna nga një numër i vogël i komunitetit pakicë boshnjak (3 veta) dhe atij turk (2 veta).

## GJETJET KRYESORE

- Besueshmëria e opinionit publik në institucionet e rendit dhe ligjit është matur me metodën e notimit nga 1 deri në 5. Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) është institucioni me notën më të lartë 4.71; Forca e Kosovës (KFOR) me 4.04; Policia e Kosovës (PK) me 3.41; Doganat e Kosovës me 2.71; gjykatat me 2.55, prokuroria me 2.46, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) me 2.11; dhe EULEX me 1.83 pikë.
- Pjesa veriore e Kosovës cilësohet si vendi më i pasigurt në Kosovë nga 59% e të anketuarve, e që është shumë më i lartë se vendi i dytë më i pasigurt – Peja me 6.59% e të anketuarve.
- Format e kriminalitetit që qytetarët i konsiderojnë si më shqetësuese janë: vjedhjet (44%), korrupsioni (18.33%), krimi i organizuar (12%), vrasjet (11%), dhunimi (3%), trafikimi me qenie njerëzore (1.5%), e kështu me radhë.
- Të dhënat vjetore mbi numrin e përgjithshëm të krimeve ku përgjatë periudhës që ky studim merr parasysh sillen prej 87,985 raste të krimit në vitin 2002 (më e larta) e deri në 45,298 sosh në vitin 2010 (më e ulëta). Ndërkaq në vitin 2011 janë shënuar 63,108 raste të krimit.

---

<sup>1</sup> Komuniteti shqiptar përbën 92.4% të popullsisë së përgjithshme në Kosovë. Enti Statistikor i Kosovës. Anketa Demografike, Sociale dhe e Shëndetit Riprodhues në Kosovë, (Prishtina 2009).

- Supozimin se në Kosovë ekzistojnë rreth 400.000 armë e dëshmojnë edhe të dhënat nga anketat, ku një përqindje e lartë e qytetarëve (33.83%) pranojnë se mbajnë armë, ku 59.11% e tyre deklarojnë që i mbajnë ato pa leje. 70.44% e të anketuarve janë deklaruar se armët i mbajnë më tepër si nevojë për sigurinë e tyre personale dhe të pasurisë së tyre, e më pak i mbajnë ato si traditë.
- Shumica apo 47.84% e të anketuarve përgjigjen e policisë ndaj nevojave dhe kërkesave të tyre për rend dhe siguri e vlerësojnë si mesatare, një pjesë e tyre (31.83%) e vlerëson si të kënaqshme, ndërsa 20.33% e tyre e vlerësojnë si jo të kënaqshme.
- Edhe pse *policia e komunitetit* është e njohur nga reklamimet e vazhdueshme në mjetet e informimit, 66.83% e të anketuarve deklarojnë se patrullimet e policisë nëpër lagjet e tyre janë të pamjaftueshme, e në disa vende (vise rurale) mungojnë fare. Mes tjerash, 18% e të anketuarve theks të veçantë i vejnë vonësës në reagim nga ana e Policisë së Kosovës pasi të jenë thirrur nga qytetarët.
- Sa i përket bashkëpunimit të qytetarëve dhe policisë, 96.33% e të anketuarve deklarojnë se janë të gatshëm të bashkëpunojnë me policinë në rast se kërcënohen apo pësojnë nga ndonjë krim. Në një masë të ngjashme, apo 94.83% e tyre, deklarojnë se të njëjtën gjë do ta bënin edhe për komshin, gjë që tregon se gatishmëria e qytetarëve për bashkëpunim me policinë është në nivel të lartë..
- Ndërkaq, sa i përket sjelljes së policëve, 21% e të anketuarve cilësojnë mirësjelljen si karakteristikë të PK-së, ndërsa 14% e vlerësojnë sjelljen e keqe si karakteristikë të këtij institucioni.
- Korrupsioni nuk veçohet si karakteristikë e PK-së, ku 88.33% e të anketuarve thonë se nuk kanë pasur rast që policia të ketë kërkuar ryshfet.
- Ndërkaq 90.66% e të anketuarve deklarojnë se nuk janë keqtrajtuar nga pjesëtarët e PK-së.

## 1. PERCEPTIMI I OPINIONIT MBI SIGURINË PUBLIKE

### 1.1. Cili ka qenë viti më i pasigurt në Kosovë?

Nga përgjigjet në këtë pyetje mund të shihet se cilat vite dhe ngjarje në të kaluarën kanë paraqitur pasiguri për qytetarët në Kosovë. Siç shihet nga figura nr. 1 e mëposhtme, në Kosovë kryesisht janë shënuar katër ngjarje që kanë zgjuar ndjenjën e pasigurisë në vend: viti 2000 që shënon fillet e para të kohës në liri, konstituimin e institucioneve vendore<sup>2</sup>; pastaj është viti 2004 që shënon trazirat e marsit; viti 2008 që shënon shpalljen e pavarësisë së Kosovës; dhe viti 2011 që shënon barrikadimin e pjesës veriore të Kosovës nga ana e një pjese të qytetarëve serb me ndihmën e strukturave paralele të sigurisë të Serbisë.




Figura nr. 1: Vitet më të pasigurta në Kosovë

Nga të anketuarit, 32.5% e tyre janë deklaruar që vitet 2000 dhe 2004 kanë qenë më të pasigurt. Si arsye për pasiguri në vitin 2000, të anketuarit janë deklaruar se ka ekzistuar frika e vazhdimit potencial të luftës, përçarjet ndëretnike, mungesa e institucioneve përgjegjëse për siguri, si dhe kriminaliteti i lartë. Ndërsa si arsye për pasiguri në vitin 2004 të anketuarit kanë theksuar trazirat e marsit të cilat si pasojë kanë pasë edhe përçarjet ndëretnike. Kurse sa i përket vitit 2008, 2.5% e të anketuarve e kanë cilësuar këtë vit si të pasigurt, ndërsa si arsye e kësaj është frika nga ndonjë luftë apo konflikt të mundshëm sikurse ato të marsit 2004 pas shpalljes së pavarësisë. Kurse për vitin 2011, janë 12.10% e të anketuarve që e kanë cilësuar si të pasigurt, dhe si arsye për këtë është barrikadimi i pjesës veriore të Kosovës nga strukturat paralele serbe të sigurisë. Me gjithë atë një përqindje jo e vogël e të anketuarve, apo 20.30% e tyre, nuk kanë qenë në gjendje të vendosin se cili vit ka qenë më i pasigurt për ta.

### 1.2. Cilat nga llojet e krimit ndiheni të kërcënuar?

Si përgjigje në këtë pyetje, të anketuarit kanë radhitur llojet më të shumta të krimit nga të cilat të anketuarit ndihen më të kërcënuar. Siç shihet në figurën nr. 2 të mëposhtme, prej krimeve më kërcënuese për sigurinë e tyre kanë listuar vjedhjet (44% e tyre), korrupsionin (18.33% e tyre), krimin e organizuar (12% e tyre), vrasjet (11.16% e tyre), dhunimin (3% e tyre), trafikimin me qenie njerëzore (1.5% e tyre). Ndërsa prostitucionin, kidnapimin, dhe terrorizmin e kanë cilësuar si kërcënim më pak se 1% e të anketuarve për secilin nga këto krime.

<sup>2</sup> Institucionet e para vendore pas luftës në Kosovë u krijuan në vitin 2000




Figura nr. 2: Krimet që paraqesin shqetësim në Kosovë

Të dhënat e siguruar nga PK-ja për vrasjet në Kosovë flasin se që nga janari i vitit 2000e deri në vitin 2011 janë regjistruar 1,134 vrasje.<sup>3</sup> Kjo ka bërë që deri në vitin 2006 Kosova krahasuar me 12 shtete të BE-së<sup>4</sup> për nga numri i vrasjeve për 1,000 banor të del me numër më të madh të vrasjeve (e para në listë).<sup>5</sup> Sipas tabelës dhe figurës nr. 3 më poshtë shihet se edhe pse trendi i numrit të vrasjeve në Kosovë është në rënie të vazhdueshme, në vitin 2004 vërehet një rritje e këtij numri në krahasim më vitin 2003. Ky trend i vrasjeve po ashtu përshtatet edhe me perceptimin e publikut sa i përket vitit më të pa sigurt që të anketuarit kanë cilësuar vitin 2000 dhe 2004.

Numri i vrasjeve në Kosovë sipas vitit:

Viti	'00	'01	'02	'03	'04	'05	'06	'07	'08	'09	'10	'11
Vrasje	319	177	129	77	85	77	62	63	49	34	39	23 <sup>6</sup>




Figura nr. 3: Numri i vrasjeve në Kosovë sipas vitit

<sup>3</sup> Policia e Kosovës, Email i dërguar tek autori, mars 30, 2012

<sup>4</sup> Këto shtete janë; Austria, Belgjika, Danimarka, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Holanda, Portugalia, Spanja dhe Anglia. krahasimi i Kosovës me këto shtete është bërë nga Inspektorati Policor i Kosovës. Këto shtete janë marr parasysh gjykuar që janë ndër shtete më të zhvilluara të Evropës.

<sup>5</sup> Policia e Kosovës, Raporti Vjetor i Inspektoratit të Policisë së Kosovës. (Prishtina, 2006), 72. <http://ipk.rks-gov.net/Reports/RaportVjetor2006.pdf>

<sup>6</sup> Policia e Kosovës, Email i dërguar tek autori, mars 30, 2012



Sa i përket krimit në përgjithësi, sipas të dhënave nga PK-ja, shihet se numri i krimeve të regjistruara në Kosovë nuk kanë ndonjë trend të caktuar. Shihet se trendi ka qenë në një rritje të theksuar prej pas luftës për t'u ndalur kjo rritje në vitin 2002. Nga viti 2002 e deri në vitin 2008, vit ky kur edhe u shpall pavarësia e Kosovës, shihet një trend në rënie edhe pse të ngadalshme. Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, trendi i vrasjeve në Kosovë nuk shënon ndonjë rënie, përkundrazi shënon ngritje arbitrare sipas vitit në vit deri më 2011.

*Numri i përgjithshëm i krimeve të regjistruara:*

Viti	'00	'01	'02	'03	'04	'05	'06	'07	'08	'09	'10	'11
Krim.	50,754	78,753	87,985	72,230	72,965	74,550	73,395	67,427	49,583	64,661	45,298	63,108 <sup>7</sup>




Figura 4: Numri i krimeve të regjistruara në Kosovë sipas vitit

### 1.3. Cilat nga vendet (qytet apo fshat) keni frikë t'i vizitoni?

Nga përgjigjet në këtë pyetje nga të anketuarit mësohet se nga vendet më të rrezikshme (apo vende të cilat qytetarët kanë frikë t'i vizitojnë më së shumti), sipas figurës nr. 5 më poshtë janë: pjesa veriore e Mitrovicës (59.66% e të anketuarve). Pas Mitrovicës radhitet Peja (nga 6.59% e të anketuarve) - kjo për arsye të kriminalitetit të lartë, gjegjësisht vrasjeve të shumta. Pas Pejës radhitet Brezovica (nga 4.33% e të anketuarve) – kjo për arsye, siç edhe janë shprehur të anketuarit, frikës nga serbët lokal. Po për të njëjtën arsye e kanë cekur edhe Graçanicën ku vetëm 3.67% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë frikë ta vizitojnë këtë vend. Ndërkaq, jo shumë nga të anketuarit janë deklaruar se kanë frikë ta vizitojnë kryeqytetin në krahasim me vendet tjera, ku 2.33% e tyre janë deklaruar për një gjë të tillë. Ndërkaq me një përqindje më të ulët, gjegjësisht 2% e më poshtë e të anketuarve janë deklaruar se kanë frikë për t'i vizituar këto vende: Deçanin, Shtërpçën, Podujevën, dhe Drenicën.

<sup>7</sup> Policia e Kosovës, Email i dërguar tek autori, mars 30, 2012




Figura nr. 5: Vendet më të rrezikshme sipas opinionit në Kosovë

#### 1.4.A posedoni armë zjarri ju apo ndonjë nga anëtarët e familjes suaj?

Nga përgjigjet e të anketuarve në këtë pyetje del që shumica apo 66.16% e tyre nuk posedojnë, ndërsa pjesa tjetër apo 33.83% e tyre posedojnë armë zjarri (shih figurën nr. 6 më poshtë). Edhe pse shumica janë deklaruar se nuk posedojnë armë, megjithatë përqindja e atyre që posedojnë është tejet e lartë, duke marr parasysh këtu edhe hezitimin potencial të të anketuarve për tu përgjigjur afirmativ në këtë pyetje.




Figura nr. 6: Armëmbajtja në Kosovë

Si rezultat i vakumit ligjor dhe daljes nga lufta e armatosur e fundit të viteve '90 në Kosovë, armëmbajtja ishte dukuri mjaft e pranishme duke shtuar këtu edhe mos aftësinë e autoriteteve të rendit ta parandalojnë një gjë të tillë. Sipas një analize<sup>8</sup> mbi armëmbajtjen në Kosovë, thuhet se armët i mbajnë 4 kategori të individëve. (1) luftëtarët e luftës së fundit të cilët kanë lidhje emocionale me armët; (2) personat që armët i konsiderojnë si nevojë për mbrojtje nga kërcënimi i kriminalitetit; (3) personat që kanë pasur rast të posedojnë armë

<sup>8</sup> Fadil Kajtazi, "Armët larg qytetarëve," Telegrafi, Nëntor 08, 2010 <http://www.telegrafi.com/lajme/armet-larg-qytetareve-26-2808.html>

gjatë kohës së luftës; dhe (4) personat që mbajnë armët me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve kriminale.

Në Kosovë gjenden prej 350.000 deri 400.000 armë pa leje<sup>9</sup>, çka do të thotë se mesatarisht çdo familje posedon një ose më shumë armë zjarri.<sup>10</sup> Ndërsa sa i përket lejeve për armëmbajtje shumica e të anketuarve apo 59.11% e tyre janë deklaruar se armën apo armët e zjarrit i mbajnë pa leje, ndërkaq pjesa tjetër apo 40.88% e tyre janë deklaruar se ato i mbajnë me leje.




Figura nr. 7: Grupimi i armëmbajtjeve sipas lejes (me apo pa leje) në Kosovë

Sa i përket arsyes së armëmbajtjes në pyetjen se “a mbani armë për nevojë apo si traditë?” shumica e të anketuarve apo 70.44% e tyre janë deklaruar se armën e mbajnë për nevojë, ndërsa pjesa tjetër apo 29.55% atë e mbajnë si traditë (shih figurën nr. 8 më poshtë)




Figura nr. 8: Arsyet e mbajtjes së armës në Kosovë (si nevojë apo si traditë?)

Me qenë se në Kosovë, për veç tri amnistive për dorëzimin e armëve që ka shpallur UNMIK-u në vitet e para të pas luftës, nuk ka pas ndonjë amnisti tjetër të lajmëruar në Kosovë. Sa i përket kësaj çështje, me përgjigjet e marra në pyetjen se “a jeni të gatshëm ta dorëzoni armën?” siç shihet edhe në figurën nr. 9 më poshtë, shumica e të anketuarve apo

<sup>9</sup> Sipas KPK, neni 328, paragrafi 1, kryhet vepër penale e armëmbajtjes, “Kushdo që mban në pronësi, kontrollon, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar për atë armë,...”.

<sup>10</sup> UNDP, USAID, and Riinvest, Raporti i Paralajmërimit të Hershëm. Raporti # 12. Tetor-dhjetor 2005, [http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/ewr12\\_eng.pdf](http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/ewr12_eng.pdf)

63.54% e tyre janë përgjigjur negativisht, ndërsa pjesa tjetër apo 36.45% e tyre janë përgjigjur pozitivisht.




Figura nr. 9: Gatishmëria e qytetarëve për të dorëzuar armët

Ndërsa sa i përket masave për zbulimin dhe konfiskimin e këtyre armëve që organet e rendit do të duhej t'i ndërmerren, të anketuarit janë pyetur se “a keni pasë rast të jeni kontrolluar ndonjëherë nga policia për armë? ku përmbi 94.33% e tyre janë deklaruar se as një herë nuk janë kontrolluar për armë nga policia, ndërsa vetëm një numër i vogël i tyre 5.66% janë deklaruar se janë kontrolluar , kryesisht në vitet e më hershme. Pra duket qartë që nuk janë marr masat e nevojshme për konfiskimin e këtyre armëve nga ana e organeve të rendit.




Figura nr. 10: Kontrolli për armë nga ana e autoriteteve (policia)

## 2. PERCEPTIMI I OPINIONIT MBI PUNËN POLICORE

### 2.1. Si i vlerësoni organet e rendit dhe të drejtësisë?

Kjo pyetje iu është shtruar të anketuarve në formën e notimit të organeve të rendit dhe të drejtësisë. Të anketuarit kanë pasur rast të vlerësojnë secilin nga institucionet e shënuara në figurën nr. 11 më poshtë me notën prej 1 (dobët) deri 5 (shkëlqyeshëm). Sipas vlerësimit të të anketuarve del se institucionet që kanë marr notë më pozitive apo mbi mesatare janë: Forca e Sigurisë së Kosovës (4.71 pikë), KFOR-i (4.04 pikë), dhe Policia e Kosovës (3.41 pikë). Ndërkaq me një notë mesatare apo nën mesatare janë Doganat e Kosovës (2.71 pikë), gjykatat (2.55 pikë), prokuroria (2.46 pikë), dhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (2.11 pikë). Ndërkaq i vetmi institucion që nuk ka marr notë kaluese është EULEX-i i cili është vlerësuar me 1.83 pikë.




Figura nr. 11: Rënditja e organeve të rendit dhe drejtësisë në Kosovë për nga besueshmëria

### 2.2. Çka vlerësoni si përparësi tek Policia e Kosovës?

Siç edhe shihet nga figura nr. 12 më poshtë, afro gjysma e të anketuarve, apo 46.16% e tyre nuk janë deklaruar fare për përparësitë apo të mirat e PK-së, pra kanë refuzuar t'i përgjigjen kësaj pyetje. Me gjithë atë, 21% e të anketuarve janë deklaruar se mirësjellja e policisë është njëra nga përparësitë. Ndërkaq 14% e tyre si përparësi e shohin vet faktin që kanë policë të Kosovës pra fakti që flasin shqip dhe mbajnë uniformë të Kosovës. Një përqindje më e vogël e të anketuarve, apo 6.33% e tyre flasin për reagim të shpejtë të policisë si përparësi e kësaj të fundit; 4.83% e tyre kanë theksuar se pajisjet moderne teknika (vetura, uniforma) janë përparësi tek PK-ja. Ndërsa vetëm një përqindje shumë e vogël, apo 0.83% e tyre e vlerësojnë moshën e re si përparësi – pra kjo do të thotë që në mungesë të moshës së re në polici, shumë pak e vlerësojnë si përparësi. Përqindje edhe më e vogël e të anketuarve flet për mungesë të korrupsionit në polici dhe multi-etnicitetin si përparësi.




Figura nr. 12: Përparësitë që ka Policia e Kosovës sipas opinionit

### 2.3. Çka vlerësoni si të metë tek Policia e Kosovës?

Sikurse për përparësitë e policisë, siç edhe mund të shihet nga figura nr. 13 më poshtë, shumë të anketuar apo 41% e tyre nuk janë deklaruar apo kanë refuzuar t'i përgjigjen kësaj pyetje. Megjithatë, 18% e tyre kanë vlerësuar se reagimi me vonësë është si e metë e PK-së. Po ashtu 14% e të anketuarve kanë theksuar se keq-sjellja e policisë ndaj qytetarëve është një e metë tjetër, e po të krahasohet me të dhënat nga figura nr. 12 e lartpërmendur, del se më shumë janë deklaruar për mirësjellje se sa për keq-sjellje të policisë. Ndërsa nëse bëhet një krahasim ndërmjet figurës nr. 12 dhe nr. 13 sa i përket gjërave tjera, atëherë vërehet se më shumë flasin për këto gjëra si e metë se sa si përparësi e policisë. Kështu 7% theksojnë se niveli i ulët i arsimit është e metë; 6.50% e tyre e theksojnë korrupsionin si të metë; 5.83% e theksojnë jo-efikasitetin në luftimin e krimit; 4.66% e tyre theksojnë jo-profesionalizmin, e kështu me radhë.




Figura nr. 13: Të metat që ka Policia e Kosovës sipas opinionit

#### 2.4. Si e vlerësoni përgjigjen e policisë ndaj nevojave dhe kërkesave tuaja?

Duke iu sqaruar të anketuarve se kjo pyetje nënkupton përgjigjen e policisë për mbajtjen e rendit dhe sigurisë së përgjithshme në nivelin e duhur, që paraqet edhe nevojë dhe kërkesë të shoqërisë, siç edhe shihet nga figura nr. 14 më poshtë, 47.84% e të anketuarve kanë dhënë vlerësim mesatar. Ndërkaq një numër i konsiderueshëm, apo 31.83% e tyre kanë dhënë vlerësim të kënaqshëm, ndërsa një numër më i vogël apo 20.33% e tyre kanë dhënë vlerësim jo të kënaqshëm.




Figura nr. 14: Vlerësimi i policisë në kryerjen e detyrave

#### 2.5. Në rast se kërcënoheni apo pësoni nga ndonjë krim, a do të lajmëroni policinë?

Siç paraqitet në figurën nr. 15 më poshtë, shumica e të anketuarve apo 96.33% theksojnë se do ta lajmëronin policinë në rast se pësojnë nga ndonjë krim. Ndërsa një pjesë e vogël e tyre, apo 3.66% deklarojnë se nuk do ta bënin një gjë të tillë. Sipas kësaj mund të konstatohet se qytetarët e Kosovës me gjithë atë kanë besim dhe mbështeten tek Policia e Kosovës kur atyre iu kërcënohet siguria e vet personale.




Figura nr. 15: Raportimi i krimeve në polici ku ka kërcënim direkt

Qytetarët e Kosovës nuk e lajmërojnë policinë vetëm në rastet kur kanë kërcënim direkt apo kur vet pësojnë nga ndonjë krim. Ata do ta lajmëronin policinë edhe kur ndonjë krim

nuk i dëmton ata direkt por kur ai përgatitet apo nëse veç është kryer tek komshiu. Kështu, siç shihet në figurën nr. 16 të mëposhtme, shumica e të anketuarve apo 94.83% e tyre janë deklaruar se do ta lajmëronin policinë nëse ndonjë krim është duke u përgatitur apo vetëm se është kryer tek dikush tjetër (komshiu). Ndërsa një numër i vogël, apo 5.16% e tyre deklarojnë të kundërtën. Pra një numër i vogël nuk do të bashkëpunonin me policinë për shkaqe sigurie personale me gjithë faktin që ekziston Ligji mbi Mbrojtjen e Dëshmitarit.




Figura nr. 16: Raportimi i krimeve në polici kur ka kërcënim indirekt

#### 2.6.A mendoni se është i mjaftueshëm patrullimi i policisë në lagjet tuaja

Qëllimi i kësaj pyetje është të vlerësohet koncepti i *policisë së komunitetit* të cilin e zbaton PK-ja. Përkundër ekzistimit të këtij koncepti, që nënkupton praninë dhe patrullimin e shpeshtë të policisë nëpër lagje, sipas të anketuarve duket se *policia e komunitetit* nuk jetësohet aq sa edhe proklamohet. Siç vërehet në figurën nr. 17 më poshtë shumica apo afro 66.83% e tyre deklarojnë se prania e policisë në lagjet e tyre nuk është i mjaftueshëm, ndërsa pjesa tjetër, përmbi 33.16% e tyre deklarojnë se prania apo patrullimi i policisë në lagjet e tyre është i mjaftueshëm. Mirëpo ka edhe prej atyre që deklarojnë se fare nuk shohin patrullim të policisë, gjë e cila ndodh në viset rurale.




Figura nr. 17: Patrullimi i policisë nëpër lagje



## 2.7.A jeni keqtrajtuar ndonjë herë nga policia?

Me përgjigjet në këtë pyetje është vlerësuar perceptimi i qytetarëve nëse ndonjëherë janë keqtrajtuar në një formë apo tjetrën kur kanë qenë në kontakt me policinë. Siç edhe shihet nga figura nr. 18 më poshtë, një shumicë e konsiderueshme apo 90.66% e të anketuarve janë deklaruar se nuk janë keqtrajtuar nga Policia e Kosovës. Ndërsa pjesa tjetër, apo 9.33% e tyre janë deklaruar se janë keqtrajtuar nga policia në formë kryesisht të rrahjes, shprehjeve banale, fyerjet dhe ngacmimet, e kështu me radhë.




Figura nr. 18: Niveli i keqtrajtimit të policisë ndaj qytetarëve

## 2.8.A keni pasur rast kur policia ka kërkuar ndonjë dhuratë për të kryer apo mos kryer ndonjë shërbim ndaj jush?

Dukuria e korrupsionit siç edhe ceket më lartë është e pranishme në çdo institucion dhe çdo nivel në Republikën e Kosovës. Se si e perceptojnë qytetarët këtë dukuri në PK mund të shihet nga të dhënat e figurës në. 19 më poshtë. Siç edhe shihet një shumicë e konsiderueshme apo 88.33% e tyre janë përgjigj se nuk kanë pasur rast që policia të ketë kërkuar ryshfetit. Me gjithë atë një numër jo i vogël apo 11.66% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë pas rast të tillë. Kështu një i dënuar mashkull i moshës 23 vjeçare nga Mitrovica deklaroi: “Kur unë isha dënuar me burg, pasi kisha kryer një vepër penale (falsifikim parash), një polic më ka kërkuar 10.000 Euro (dhjetë mijë euro), për të më mundësuar mos ta vuaj dënimin”<sup>11</sup>




Figura nr. 19: Prania e korrupsionit në polici

<sup>11</sup> Deklaratë dhënë gjatë anketimit me një mashkull 23 vjeçar. Mitrovicë, 2012

### 3. KONKLUZIONE

Sipas opinionit, që nga përfundimi i luftës në vitin 1999, vitet më të pasigurta në Kosovë cilësohen vitet 2000 dhe 2004, ndërsa në një masë më të ulët viti 2008 dhe ai 2011.

Rezultatet e matjes së opinionit publik tregojnë një shpërputhje ndërmjet imazhit ndërkombëtar të Kosovës dhe brengave të qytetarëve. Derisa në perspektivën ndërkombëtare ekziston perceptimi se Kosova është qendër e krimit të organizuar, korrupsionit dhe trafikimit me qenie njerëzore, brenda Kosovës qytetarët janë më së shumti të brengosur nga vjedhjet, pas të cilave radhiten krimi i organizuar, korrupsioni dhe në masë jashtëzakonisht të vogël trafikimi me qenie njerëzore.

Që nga vera e vitit 2011, kur Qeveria e Kosovës dërgoi njësitet speciale të Policisë së Kosovës në pjesën veriore e që solli barrikadimin e rrugëve kryesore në pjesën veriore të Kosovës nga ana e strukturave paralele të sigurisë së Serbisë, gjendja në pjesën veriore të vendit shihet si kërcënimi më serioz për sigurinë në shtet nga ana e qytetarëve. Gjithashtu, status-quoja në këtë pjesë shihet nga qytetarët si potencial për konflikt të ri ndër-etnik.

Besimi i qytetarëve në institucionet e rendit dhe ligjit vazhdon të jetë në trend të njëjtë me të gjitha hulumtimet e opinionit të publikuara gjatë dekadës së fundit. Derisa FSK, KFOR dhe Policia e Kosovës prijnë me besueshmëri, gjykatat dhe prokuroritë kanë besim më të ultë, ndërsa EULEX-i mbetet i fundit sa i përket besueshmërisë nga ana e qytetarëve. Kjo e fundit edhe tregon se as qytetarët e Kosovës nuk kanë më pritje se misionit i BE-së për sundimin e ligjit mund të ndihmojë në përforcimin e rendit, ligjit si dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Kosovë.

Ndërsa në fund por e rëndësishme, çka shihet tek këto të dhëna është se Policia e Kosovës vazhdon të jetë në mënyrë permanente, që nga viti 2000, institucioni në të cilin qytetarët kanë besim shumë të lartë, i cili sipas opinionit konsiderueshëm cilësohet si i pa-korruptuar dhe profesional në punë.